

EQREM ÇABEJ

SHQIPJA DHE GJUHËT FQINJE ¹

Gjuha shqipe flitet sot në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe në trevat përreth të Jugosllavisë e të Greqisë prej afërsisht katër milion banorësh, po të shtojmë dhe ngulimet e shpërndara në Dalmaci, në Itali jugore e Siqeli, në Greqi të mesme e jugore me gjithë ishujt përreth, në Bullgari, Rumani, Turqi, në Bashkimin Sovjetik, në Egjipt, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në vise të tjera.

Dëshmimi i shqipes me anë të shkrimit, pas njohurive që kemi, është mjaft i ri. I pari tekst i datuar i shkrimit shqip është Formula e pagëzimit e vitit 1462, e cila gjindet në dorëshkrim në Bibliotekën Laurentiana të Firences dhe u botua sëpari prej historianit rumun N. Jorga ². Ka ndërkaq disa shenja që tregojnë se gjuha ka qenë shkruar më parë. Shohim kështu se në një kumt që ka lënë në vitin 1332 dominikani freng Gulielmus Adae, i quajtur dhe Brocardus, arqipeshkv i Tivarit, thuhet «Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris» ³. Të parin lajm për gjuhën shqipe përgjithësisht e gjejmë në një dokument të Raguzës të vitit 1285, ku ndër të tjera thuhet «audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca» ⁴. Mungesa e përmendoreve gjuhësore nga koha e mesjetës së hershme e të plotë kompensohet gjer diku me emrat e personave e të viseve që dalin nëpër dokumentet e asaj kohe, emra që gjinden në veprën «Acta Albaniae» botuar nga Thallóczy-Jireček-Sufflay e në përmbledhje të tjera, dhe që janë me rëndësi sidomos për fjalëformimin e shqipes. Një tjetër burim për rindërtimin e shkallës paralettrare të gjuhës gjin-

1) Ligjëratë mbajtur më 18.I.1966 në Universitet të Vjenës dhe botuar sëpari gjermanisht në revistën «Die Sprache» XIII (1967), fashikull 1, f. 39-51.

2) Në «Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades, IV^e série», f. 195. Khs. edhe M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais* (1932) 7.

3) «Shqiptarët, ndonëse kanë një gjuhë krejt më vete e të ndryshme nga gjuha latine, megjithatë në marrëdhëniet e përditshme e në gjithë librat e tyre përdorin shkronjat latine». Khs. Ch. Kohler, *Recueil des historiens des Croisades, Documents arméniens t. II* (1906) 483vv.; E. Durham, *Some Tribal Origins, Laws, and Customs of the Balkans* (1928) 16; M. Domi, Buletin për shkencat shoqërore 1955, Nr. 1, f. 3; G. Schirò, *Storia della letteratura albanese* (1959) 10; *Historia e letërsisë shqipe I* (1959) 156 shënim 7, me literaturë.

4) «Ndjeva një zë që thërriste në mal në gjuhë shqipe». *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt Dr. L. de Thallóczy, Dr. C. Jireček et Dr. E. de Sufflay I* (1913) 527 c; Sufflay, *Ungarische Rundschau* 5 (1916) 6, me literaturë.

det në elementet e shqipes që kanë kaluar te gjuhët fqinje me të, të cilat do të na dalin disa herë në vijim të këtij studimi.

Gjuha shqipe, në formën me të cilën na paraqitet sot, ndahet në dy dialekte ose grupe të folmesh, gegërishten në pjesën veriore, verilindore e lindore të trevës gjuhësore të shqipes, dhe toskërishten në pjesën jugore të saj. Një vështrim historik i gjuhës dhe i dialekteve të saj na tregon qartë që gegërishtja, gjatë periodës letrare të këtyre katër shekujve të fundit, sidomos me reduktimin e diftongjeve e të grupeve vokalike në zanore të thjeshta të gjata dhe të disa grupeve bashkëtingëlloresh në bashkëtingëllore të thjeshta, u ka larguar prej tipit të përbashkët të gjuhës e njëkohësisht dhe prej toskërishtes, e cila në këto pika i ka qëndruar më besnike këtij tipi. Për periodën paraletrare përkundrazi gegërishtja paraqitet më konservative se toskërishtja, e cila ndër të tjera ka kryer ndrimin e *a*-së hundore në zanoren e mesme *ë*, rotacizmin e *n*-së ndërzanore në fjalë të tilla si *rërë*: geg. *ranë* prej lat. *arena*, dhe hapjen e *vo*-së nistore në *va*- në fjalë si *voj vaj* prej lat. *oleum*. Prandaj forma *vatra*, e përhapur në disa gjuhë ballkanike, kur krahasohet me geg. *vo tër votra*, tosk. *vatër vatra*, na tregon se ky dallim dialektor i veçantë ishte kryer heret në shqipen dhe se gjuhët fqinje kanë marrë këtë formë sekundare të fjalës. Te ndonjë dukuri siç është asimilimi i grupeve *kl* edhe *gl* në grykore të thjeshta, në rasa të tilla si *klumësht* e *gluhë*, të dyja grupet dialektore, me pak përjashtime, kanë kryer një risim, një inovacion. Nazalizmi në sistemin fonetik dhe paskajorja në sistemin morfologjik të gegërishtes, pas mendimit tonë nuk duan kuptuar kështu, që të kenë qenë dikur të mbarë gjuhës e që t'i ketë bjerrë pastaj toskërishtja. Në lidhje me këto tipare është për të vënë re edhe kjo, që përbrenda truallit të gegërishtes shfaqen që heret disa dukuri, të cilat për një pjesë janë më të lashta se dallimet që ekzistojnë midis gegërishtes e toskërishtes. Hyn aty errësimi i *a*-së në *o* në pozicion nazal dhe hapja e *u*-së në *o* në trevën lindore të gegërishtes, sikundër del nga dëshmia e gjuhëvet fqinje; le të krahasohet më një anë emri i gurrës me ujë të ëmbël *Ombla* pranë Gravozës afër Raguzës, ku përmbahet trajta *ombël* në vend të *ambël* fem. *ambla*, më anë tjetër emri sllavisht *Skoplje* i qytetit të Shkupit, shqip *Shkup*, në kohën antike *Scupi*. Duke përmbledhur këto të gjitha, rezulton që struktura dialektore e shqipes, ashtu si ndodh edhe me gjuhë të tjera, është përfundimi i një zhvillimi gjatë kohëve. Tiparet që dallojnë dialektet nga njëritjetri, edhe në këtë gjuhë nuk janë përftuar njëkohësisht, po pak nga pak e shkallë-shkallë, dhe me grumbullimin e tyre erdhën e u formuan me kohë dy grupe dialektore më vete. Me këtë gjendje, nga fusha etnografike pajton fakti që në dokumentet mesjetare nuk dalin asgjëkund emrat gegë edhe toskë.

Shqipja dihet se është një mis i familjes gjuhësore indoeuropiane. Këtë e pat vënë re që më 1834 Rasmus Rasku, të cilin e pasuan J.v. Xylanderi, Schleicheri e G. Stieri⁵, po që Franz Boppi ai, që në punimin e tij mund të themi gjenial «Përmbi shqipen në marrëdhëniet e saj të afërisë» (1854), e vërtetoi këtë me një paraqitje e argumentim të shtjelluar. Shkollës austriake me Hahnin, Miklosichin, Schuchardtin, Kretschmerin,

5) Khs. H. Pedersen, *Philologica* 2 (1923-24) 110; N. Jokl, *Albanisch* (Geschichte der idg. Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch F. Bopp, 1917, f. 118v.), *Die Sprache* IX 113v.

Meyer-Lübken, po sidomos me Gustav Meyerin dhe Norbert Joklin, i mbeti barra të vinte themelet e studimit gjuhësor të shqipes. Krahas me ta do përmendur puna e Holger Pedersenit. Gjuhësia e re shqiptare ia ka hyrë punës të marrë në dorë trashëgiminë e këtyre realizimeve dhe t'i çojë këto më përpara, të nxjerrë në dritë në një shkallë sa më të plotë visaret e gjuhës, që për një pjesë të mirë ende janë të pazbuluara, dhe t'i studiojë ato bashkë me dijetarët e vendeve të tjera.

Vendi që ka shqipja në rrethin e gjuhëve indoeuropiane ka qenë shpeshherë objekt kërkimesh shkencore. Me gjithë se janë arritur aty disa rezultate që mbeten, për të ardhur në një gjykim përfundimtar duhet të kryhen një varg punimesh paraprahe. Në fushën e fonetikës historike, ndërtesa e ngrehur kryesisht prej Gustav Meyerit, në pjesët e saj kryesore qëndron, veçse në mjaft pika duan kryer ndryshime. Nga çështjet e veçanta të periodës së lashtë të gjuhës, ajo e mënyrës së reflektimit të guturave kërkon një trajtim të ri edhe pas monografisë së njohur të Pedersenit. Nuk është vënë re ose vlerësuar sa duhet fakti që zotërojnë disa rregulla të caktuara në punë të raporteve të kuantitetit, që indoeur. *ai* ka dhënë në shqipen edhe *a*, indoeur. *j* në ballë fjale ka dhënë *z*- ashtu si në greqishten, që grupet *sk* edhe *ks* kanë dhënë edhe *sh*, që grupet *vr*- edhe *vl*- në ballë fjale si rezultat të fundit kanë dhënë *r*- dhe *l*-, që *nd* ka çuar në *n* (edhe në toskërishten), në fjalë të tilla si *anë*: gjerm. *Ende* «fund, mbarim». Një rishqyrtim kërkon, përveç këtyre, dhe puna e reflekseve të likuideve e nazaleve silabike, rrokjeformuese. Nga dukuritë e periodës postetnike është për të vënë re përftimi i diftongjeve pjesërisht nga segmentimi i zanoreve të gjata, pjesërisht nga takimi i dy zanoreve, pastaj gjeminacioni ekspresiv i tingullit *r*, i cili arrin të spjegojë historikisht më mirë, pra si fjalë të fushës afektive, disa forma të tilla si *burrë*, *derr*, *errët*, *rrej*, *varrë*, *vorr* *varr*. Si detyra të një karakteri të përgjithshëm duan përmendur këtu pikësëpari konstatimi i tipareve fonetike konstitutive, e pastaj ai i efekteve të fonetikës sintaktike. Rëndësi të madhe, përveç këtyre, ka edhe caktimi i një kronologjie, mundësisht dhe absolute dhe relative, të ndryshimeve fonetike. Kjo vjen në vështrim (në konsideratë) edhe në çështjen e burimit, në punën e gjykitimit të lidhjes së shqipes me gjuhët e lashta jogreke të Ballkanit, një fushë kjo, ku bash nga mospertillja e kronologjisë paraqiten e mbrohen shpeshherë mendime arbitrare. Ashtu si për tingujt, edhe për format gramatikore është me rëndësi të dihet se ku ka ruajtje të trashëgimisë indoeuropiane, ku ka formim të pavarur formash të reja, ku ka bjerrje e zëvendësim të formave të lashta të trashëgimit. Dhe ashtu si atje, edhe këtu shtrohet detyra të konstatohen tiparet konstitutive të gjuhës si dhe kronologjia e zhvillimit të dukurive të ndryshme. Ndër kategoritë e ndryshme kërkon një vëmendje të veçantë sistemi i nyjës dhe i rasave, gjithashtu dhe sistemi foljor. Edhe pjesët e palakueshme të ligjëratës, e aty sidomos ndajfolja edhe lidhëza, duhet veçanërisht të tërheqin vëmendjen tonë, ngaqë tek ato mund të shihet e të ndiqet historikisht roli fjalëformues i sandhit, i lidhjeve të fjalës në ngërthim të fjalisë. Në fushë të fjalëformimit janë përzier në gjuhën shqipe elementet e huaja me të vendit. Në trajtimin e çështjeve të sintaksës, ashtu si te trajtat rasore e foljore, edhe te llojet e fjalive duhej nisur nga faktet vetjake të gjuhës dhe të arrihej në një dallim të përdorimit specifik nacional nga tipi i përbashkët ballkanik ose nga një tip edhe më i përgjithshëm. Në punën e studimit të leksikut të shqipes, i pari

Leibnizi i vuri dijes për detyrë që të veçojë elementin e trashëguar nga huazimi. Në lidhje me elementin e trashëguar do pasur parasysh ndërkaq që jo gjithshka që bën pjesë aty, është në gjendje t'i shtrohet një krahasimi me gjuhë të tjera përmbi një bazë indoeuropiane. Ashtu si në të tjera gjuhë, edhe në shqipen jo vetëm rrjedhojat e kompozitat, po edhe fjalët onomatopeike si *bubulák* «zjarr i madh që brambullon» dhe *fink* «emër zogu, zborak», format që kanë dalë prej thirmash me të cilat ndjellin ose përzënë shtazët, si *cap*, *cjap*, dhe apelativat me burim prej emrash vetjake, si *gjon* «qokth», në thelb *Gjon*, thuajse përherë janë formime sekundare e shumica relativisht të vona të periodës vetjake, postetnike të gjuhës. Ashtu qëndron puna edhe me ato formime fjalësh që lidhen përbrenda gjuhës me disa fjalë bazë, siç janë formimet e tipit *ardhí hardhí: urth* «sherماشek», dhe *ehull* «qiri akulli»: *hell*, shumë *hej*. Relativisht të reja janë edhe formimet e fjalëve të dala prej fjalish (ose prej gjymtyrësh të fjalive), sikundër janë *kushtrim*, *mbase* e të tjera. Këto formime, të quajtura «fjalë fjalish» (Satzwörter) prej gjuhëtarit suedez A. Lindquist në një vepër më vete të botuar më 1961, dhe më parë prej I. A. Hartungut në veprën e tij «Teori e pjesëzave të gjuhës greke» (I 333) botuar që më 1833, në gjuhën shqipe dalin me shumicë të madhe. Përveç këtyre rrethanave, etimologjia duhet të ketë parasysh këtë, që në shqipen, si një gjuhë të dokumentuar relativisht vonë me përmendore të shkrimit, nuk janë të pakta ato fjalë, të cilat kanë pësuar një ndryshim bukur të madh të kuptimit të tyre. Hyjnë aty ndër të tjera *blej* edhe *shes*, *dasmë*, *darsmë*, *finjë*, *mullë*, *ndër*, *rrej*, *sý*, *shijë*, *urë*. Janë sidomos disa abstrakta që kanë dalë prej një përdorimi konkret.

Duke e quajtur shqipen një gjuhë indoeuropiane, me këtë është dhënë karakteri dhe lidhjet e saj gjuhësore të periodës më të lashtë, prehistorike, dhe paraballkanike. Po kur të kundrohet afria gjuhësore jo vetëm me syrin e linguistit, po edhe me atë të historianit, duke rrokur me vështrim, bashkë me gjuhët, edhe popujt si bartësit e tyre, koncepti i kësaj afrie merr një karakter më fort dinamik se statik. Me shkuljen e një populli nga viset e veta, duke lënë trojet e të parëve e duke u shpërngulur e duke zënë vend në një atdhe të ri, edhe për gjuhën e tij lindin kushte të reja. Lidhjet e vjetra të afrisë zgjidhen, dhe zëvendësohen me të reja; ose më saktë, ato lidhje merren me vete në mjedisin e ri, ku shkrihen me të rënë në një njësi të përbashkët. Në këtë vështrim, me marrëdhëniet e fqinjësisë që patën shqiptarët me popujt e tjerë të Gadishullit ballkanik, marrëdhënie që në ndonjë rasë kanë shkuar gjer në simbiozë, edhe për gjuhën e tyre u formuan lidhje të reja. Si greqishtja, ashtu edhe shqipja me kohë u bë një gjuhë indoeuropiane ballkanike.

Afria që ekziston midis gjuhëve ballkanike, e cila mund të quhet një njësi përbrenda ndryshimeve, ka bazat e saj etnografike. Edhe më parë është vënë re se popujt e këtij gadishulli paraqesin elemente të përbashkëta në kulturën e tyre materiale e mendore. Kështu sidomos Ami Boué, në veprën e tij të rëndësishme «La Turquie d'Europe», të botuar më 1841, e cila u përkthye dhe gjermanisht, ka tërhequr vëmendjen mbi gjasitë që vërehen në mënyrën e ndërtimit të shtëpive, në kuzinë e në veshje, si dhe mbi përkimet në doke e zakone, në figurat e besimeve popullore, në vallet, këngët, veglat muzikore etj. Poezisë popullore të vendeve ballkanike, me tiparet e saj të përbashkëta dhe me mënyrën e veçantë në trajtim të te-

mave, i ka kushtuar një studim Karl Dieterichu⁶. Edhe Kristian Sandfeldi i ka trajtuar përmbledhtas këto çështje në veprën e tij themelore «Linguistique balkanique» të vitit 1930. Nuk është vendi këtu të hyhet në etnografinë dhe folklorin e krahasuar të vendeve ballkanike, fusha interesante të gjurmimit shkencor, të cilat ndërkaq gjinden ende në fillimet e tyre. Vetëm do të përmendet në këtë mes se në Shqipëri vazhdojnë të ruhen disa pjesë veshjesh të lashta. Kështu, bie fjala, xhubleta e grave të Mal-sisë së Madhe, sikundër vërejtja F. Nopcsa⁷, na del që të një figurë prej dheu e periodës neolitike, që u gjet në Klishevac të Serbisë, dhe shfaqet përsëri më një anë në disa gema të Mikenës, më anë tjetër në veshjen e Artemidës në disa moneda ilire. Gjithashtu edhe për fustanin, i cili i përgjan kiltit skocez, gjinden analogji jo vetëm, si vuri re ai dijetar, në disa gjetje të Vaçit në Karniolë të Austrisë, po, sipas vrojttimeve tona, edhe në disa figura robëresh në harqet e triumfit në Romë si edhe në disa të tjera që vërehen në gërmadhat e Histrias në Rumani.

Sikundër shihet, si gjithkund, edhe në këtë gadishull të Europës jugore, elemente të stërlashta janë përzier me elemente që u shtuan më vonë, dhe një gjë e tillë duhet thënë edhe për gjuhën. Përsa i përket kësaj, aty ndërkaq rrethana shumëduarshe gjeografike, historike e sociale kanë kontribuar në afrimet e shoqishoqme. Bashkëjetesa e disa popujve në një hapësirë relativisht të ngushtë e ka bërë më intensiv shkëmbimin gjuhësor. Ndikimi kulturor i Greqisë, pushteti politik e kulturor i perandorisë romake dhe më vonë i perandorisë bizantine, ardhja dhe sundimi i sllavëve dhe më vonë ai i osmanëve, këta janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në një drejtim konvergjent dhe kanë çuar në një farë nivelimi të ndryshimeve etnike e gjuhësore. Në pikëpamje sociale, prestigji i popullit që sundonte ose që qëndronte më lart për nga shkalla e kulturës, lehtësonte pranimin ose të paktën imitimin e gjuhës së tij nga ana e popujve të tjerë. Shkathtësia gjuhësore sidomos e banorëve të zonave kufitare çoi në përdorimin e gjuhës amtare («lingua del cuore» e Schuchardtit) përbrenda shtëpisë, dhe të gjuhës tjetër, «lingua del pane», jashtë, në treg, edhe solli kështu me vete dhe bilinguizmin. Këndej rrodhi me kohë bartja e mjeteve të shprehjes të njërës gjuhë në tjetrën, dhe kur kryhej edhe ndonjë ndrim i besimit fetar, atëherë shpeshherë hiqej dorë dhe vetë nga gjuha amtare. Më anë tjetër edhe me shpërnguljen e shpeshtë të krejt një pjese të popullsisë e më nguljen e saj në një vend tjetër, në kohët e para, e përveç kësaj me transhumancën (shtegtimin periodik) të barinjve e me endjet e zejtarëve popullorë poshtë e lart, edhe me këto rrugë kanë shteg-tuar fjalët e sendet e njërës idiomë në të tjetrës.

Vendi i shqipes në rreth të gjuhëve fqinje, i shikuar nga ana e Gadishullit ballkanik, gjeografikisht do të quhet periferik, po kur kundrohet në lidhje edhe me Gadishullin apenin, i cili më viset ballkanike ka pasur gjithmonë marrëdhënie të ngushta, do të vështrohet në një farë pikëpamje si vend central. Në pikëpamje gjuhësore kjo pozitë është me rëndësi jo vetëm për shqipen, po edhe për gjuhët fqinje me të.

Marrëdhëniet greke-shqiptare në Gadishullin ballkanik burojnë prej

6) Zeitschrift des Vereins für Volkskunde XII, 1902, 145 vv., 272 vv., 403 vv.

7) Urania 1913, f. 2. — Albanien. Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens 215vv.

kohëve të mugëta të lashtësisë. Sikundër dihet që prej A. Thumbit (IF 26, 1vv.) e këtej, vetëm për gjuhën shqipe vërtetohen me siguri elemente me burim prej greqishtes së vjetër. Mënyra si janë reflektuar këto elemente në shqipen, ka rëndësi jo vetëm për këtë gjuhë, po edhe për greqishten. Kështu, bie fjala, reflektimi i gr. $\theta\phi\chi$ me anë të okluziveve përkatëse $t\ p\ k$ të shqipes, në fjalë të tilla si $\theta\omega\rho\acute{\alpha}\kappa\iota\omicron\nu$: *tarogzë* «përkrenare», $\sigma\acute{\alpha}\kappa\alpha\rho\iota\phi\omicron\varsigma$: *shkarpë* «karthje», $\lambda\acute{\alpha}\chi\alpha\nu\omicron\nu$: *lakën lakër*, dëshmon edhe nga ana e një gjuhe ballkanike shqiptimin e atyre tingujve të greqishtes si aspirata të shurdhëta, shqiptim që më parë deduktohej me anë burimesh të tjera. Fjalët që nuk hyjnë në këtë skemë, duhet atëherë të spjegohen ndryshe. Kështu p.sh. fjala *hir*, e cila vjen prej gr. $\chi\acute{\alpha}\rho\iota\varsigma$ «hir», për punë të zanores së saj rrjedh më fort prej një kohe antike të vonë sesa nga perioda greke e mesme-bizantine, dhe me këtë tregon nevojën që përbrenda elementeve me burim prej greqishtes së vjetër të ndërmerret një farë periodizimi. Për disa rasa të tjera, si *lëpjetë* e *mëllagë*, të cilat vërtet kanë lidhje me gr. $\lambda\acute{\alpha}\pi\alpha\delta\omicron\varsigma$ $\lambda\alpha\pi\acute{\alpha}\delta\eta$ edhe $\mu\alpha\lambda\acute{\alpha}\chi\eta$, po për arsye fonetike nuk integrohen dot në sistemin e greqishtes, do të mendohet pas gjase një gurrë e përbashkët për të dy gjuhët; prandaj ato do të gjykohen afërsisht ashtu si $\sigma\acute{\iota}\delta\eta$: *shegë* e si $\sigma\acute{\alpha}\kappa\kappa\omicron\varsigma$: *thes*. Interes të veçantë paraqesin elementet dorike, të cilat janë vënë re pjesërisht që më parë, si $\delta\rho\acute{\alpha}\pi\alpha\nu\omicron\nu$: *drapën drapër*, ku hyjnë dhe disa të tjera, si $\kappa\omicron\kappa\kappa\acute{\upsilon}\mu\eta\lambda\omicron\nu$ *kokkúmalon*: *kumbull*, $\sigma\acute{\alpha}\pi\omicron\varsigma$: $\kappa\lambda\acute{\alpha}\delta\omicron\varsigma$ «degë»: *shkop*, $\chi\acute{\upsilon}\lambda\omicron\varsigma$ $\chi\upsilon\lambda\acute{\omicron}\varsigma$ «lëng» (me -u-): *qull*. Për këto huazime, si gurrë e pandërmjeme vijne në vështrim ngulimet dorike të bregdetit shqiptar dhe dialektet greke veriperëndimore. Në pikëpamje sendore, materiale, tek elementet me burim prej greqishtes së vjetër mbizotërojnë bimët e kulturës, emrat e drurëve e të shtazëve, emërtimet e veglave dhe enëve të ndryshme. Që në epokën mesjetare-bizantine edhe në kohët më të vona ky ndikim përfshiu dhe sfera të tjera, sidomos edhe jetën kishtarë, kjo është e kuptueshme me rolin që ka pasur greqishtja si gjuhë e kulturës dhe e kishës. Këtij ndikimi i detyrohen ndër të tjera *Ujëti e bekuar* (*Ujëti e bekuem*) «Epifania», *Java e madhe*, *kunorë* *kurorë* «ceremoni e lidhjes së martesës», *vë kurorë*, *shtie kurorë* «celebroj martesën, martohem», fjalë e trajtuar hollësisht prej N. Joklit (Balkan-Archiv IV 206 vv.), terme të gjithmbarshme të gjuhës. Gjithashtu edhe mbishkrimi ANA OHOH ICER i një unaze që u gjet në kapërcyell të shekullit në Shqipëri veriore, e që pa të drejtë besohej të ishte e ilirishtes së Ballkanit, pas mendimit tonë në dy pjesët e para përmban fjalën $\acute{\alpha}\nu\alpha\beta\omicron\eta\theta\acute{\iota}\epsilon\iota$ «ndihmo», trajtën urdhërore të foljes $\acute{\alpha}\nu\alpha\beta\omicron\eta\theta\acute{\omega}$, e cila në greqishten mesjetare ka qenë me përdorim më të gjerë⁸.

Në çështjen nëse greqishtja, përveç se në leksik, ka ndikuar edhe mbi sistemin e formave gramatikore të gjuhëve ballkanike, sidomos përsa i përket zhdukjes së paskajores edhe formimit të një futuri voluntativ (e ardhme vullnetore), për këtë, sikundër dihet, mendimet janë të ndara. Pa hyrë këtu në këtë çështje, në lidhje me shqipen do të shënojmë se paskajorja e gegërishtes e prirë nga parafjala *me*, larg së pasuri në vetvete ndonjë element të një paskajorje paraetnike-indoeuropiane, paraqet një risim, një inovacion të këtij dialekti, zhvillimin e pjesores së panyjë në një

8) Khs. Buletin për Shkencat shoqërore 2 (1957) 122 vv., *Lingua Posnaniensis* IX 98vv., Studi Salentini XIV 337vv.

përdorim paskajor në disa lloje fjalish të caktuara. Një krahasim jo me gjuhët e Europës perëndimore, po në mënyrë metodikisht të drejtë me rrethanat e rumanishtes, e sqaron këtë gjendje mirëfilli. Le të krahasohen p.sh. rum. *trebuie făcut* «duhet bërë» dhe geg. *duhet bâ* tosk. *duhet bërë* (*do bâ, do bërë*) me rum. (te «Letra e humbur» e Luca Caragiales) *ce mai de făcut?* «ç'duhet bërë?» dhe geg. *ça me bâ?*, ku edhe rum. *de* e shq. *me* janë me funksion të barabartë⁹. Është fare e mundur ndërkaq që afërsia gjeografike e greqishtes ta ketë ndaluar shqipen jugore të përfntonte një paskajore të re si e përftoi shqipja veriore.

Ndikimin e shqipes mbi greqishten e re Gustav Meyeri (Neugriechische Studien II 64-71) e çmoi me dishka më shumë se gjashtëdhjetë fjalë. Këtë numër gjurmimet e mëpastajme e kanë shtuar. Po t'u hidhet një vështrim veprave leksikore që u botuan më vonë, shihet se ky ndikim përfshin dhe të tjera fjalë, si të mbarë gjuhës si dialektore. Ndër ato që gjer më sot dihen më pak, mund të përmenden p.sh. *μύοτης μύοτι* «μικρὸν δοχεῖον ὕδατος ἢ ἄλλου ὑγροῦ, κανάτα», prej shqipes jugore *bot* «enë e baltë me qafë të ngushtë për të mbushur e për të mbajtur ujë, shtamë», e cila hyn te *botë* «dhe, baltë, deltinë»; *ροῦσε* «κάτελθε», prej *rusem* «zbrës, varem poshtë»; *λέρα* «zhul, zdral», nga *lerë* po me këtë kuptim, një postverbal i *lyej*, një emër që ka shkuar dhe në aromunishten; *κούλιπερι κούριπενο κουριπένια*, emra llojesh të ndryshme të *kulprit*, nga *kulpër kurrpën*, e cila ka depërtuar dhe në rumanishten e aromunishten; *βένια* «dëllinjë», nga *venjë* «*Taxus baccata*, tis. bërshë; *Juniperus*, lloje dëllinjash» (pranë *enjë* «tis»), e cila ka shkuar dhe në serbokroatishten; prej pjesëzash mund të përmendim *ντότι*, si shprehje e një pamundësie, prej shq. *dot*, në ndërtime të tilla si *δὲν ἔρχομαι ντότι* «nuk mund të vij», sipas shprehjes *nuk vij dot* të shqipes. Këto dhe të tjera elemente të kësaj gjuhe kanë hyrë në greqishten pjesërisht me anë të dialekteve të Shqipërisë jugore e pjesërisht nëpërmjet të ishujve gjuhësorë shqiptarë të themeluar prej shekujsh në Greqi. Prej Shqipërisë jugore kanë depërtuar edhe elementet leksikale që përbahen në argotë e gjuhët e fshehta të zejtarëve shëtites (terzinj, mjesh-tër muratorë, voztarë) të Greqisë veriore. Nga kompozitat e formuara me mjete analoge në të dyja gjuhët dhe nga shprehjet e shuma frazeologjike të përbashkëta për to, një pjesë do ta ketë burimin në greqishten, një pjesë tjetër në shqipen. Një çështje e fundit në këtë mes është kjo, a ka edhe në greqishten e vjetër elemente të lashta shqiptare ose parashqiptare. Ndonëse kjo çështje gjer sot nuk ka qenë trajtuar me një punim më vete, në disa rasa të veçanta ka gjetur një përgjegje pozitive. Kështu, ndër të tjerë, P. Kretschmeri (Glotta XXII 216) fjalën *δύβρις · θάλασσα* «det», që gjindet në skoliet e Teokritit, e ka krahasuar me lituan. *duburys* «thellësi» dhe me shq. *dēt*, një fjalë që në Dictionarium latino-epiroticum të Frano Bardhit (1635) jepet dhe me kuptimin «profundum». Gjithashtu edhe *γανσάπης* «lloj shajaku me thakë», N. Jokli¹⁰, si një fjalë jogreke, e ka afruar me *gëzof*-in e shqipes, dhe një ide e këtij lloji duket t'i ketë shkuar nëpërmend edhe Gustav Meyerit, në f. 125 të Fjalorit etimologjik të tij. Pa hyrë në këtë çështje, deshëm të tërheqim vëmendjen mbi disa pika të

9) Khs. edhe «Revue roumaine de linguistique» X 107vv.

10) Te Walde-Hofmann I 585.

tjera, si lakon. *δίζα* «dhi»: *dhizë* «kec» edhe «dhi», *βάρικοι · ἄρνες Λάκωνες*: *vargër vërgà vërgár* «dash ose skjap i patredhur; harmëshor», *λάρος* «pulë-bardhë»: *larë* «pullë a njollë me ngjyrë të ndryshme, zakonisht të bardhë, që kanë shtazët në lëkurë», një fjalë që ka formuar dhe emra shpendsh edhe zogjsh ¹¹.

Më i fortë se ndikimi i greqishtes ka qenë për shqipen ndikimi i latinishtes. Elementi latin i kësaj gjuhe, si një refleks i të ashtuquajturës latinishte ballkanike, shkon së bashku me rumanishten dhe dalmatishten si dhe me elementin latin të greqishtes e të gjuhëve sllave jugore, po mban ndërkaq një vend më vete, meqë paraqet lidhje të ndryshme edhe me gjuhët romane perëndimore. Në pikëpamje sociale-historike, ky ndikim, në kundërshtim me rumanishten, ka karakter më fort qytetar se fshatar. Kjo shihet ndër të tjera edhe nga analiza e leksikut përgjithësisht e sidomos e gjuhës kishtare. Kjo gjuhë në pjesën mbizotëruese është e burimit latin, për një pjesë më të vogël e burimit grek, ndërsa elementet sllave mungojnë krejt, një rrethanë kjo që është me rëndësi për historinë kulturore të vendit në kohën parasllave edhe sllave të hershme. Lidhur me kronologjinë duhet shënuar që ndikimi i latinishtes mbi shqipen, sikundër shihet nga mënyra e reflektimit fonetik të fjalëve, nis që me kohët e lashta dhe vazhdon pa ndërprerje gjer aty nga mbarimi i perandorisë edhe përtej asaj kohe, gjersa ia zë vendin italishtja. Me këtë vazhdim të gjatë, edhe aty, ashtu si tek elementi grek i shqipes, shtrohet nevoja e një farë periodizimi. Kështu p.sh. trajtimi i *Diana: zana* tosk. *zëra*, me asibilimin e dentalit të saj, i përket një shkalle kohore më të moçme se *diabolus: djall*; fjala e parë ka hyrë historikisht në kohën pagane, e dyta në kohën kristiane. Më anë tjetër, huazimi i *laurus: lār, causa: kafshë* etj. ka ndodhur në një kohë para reduktimit të lat. *au* në *o*, i cili përkundrazi na paraqitet në it. *alloro* e *cosa* dhe në frgj. *chose*, të cilat rrjedhin po nga ato fjalë latine. Lidhjet e pakëputura me botën romane i sollën shqipes dhe disa huazime me burim prej latinishtes së vonë si edhe prej latinishtes mesjetare. Prej mesjetës rrjedh dhe ndonjë element gjermanik si *trevë* «krahinë; një copë kullotë ku lëshojnë qetë në prill e në maj; rahat», *shpuer shpori* «mamuz» *shpori i pulës* «ashti i gjoksit të pulës, samari i pulës», edhe *pakë* «dy pjesët me dhjamë që dalin nga kurrizi dhe nga barku i derrit të therur», e cila depërtoi në shqipen nëpërmjet të gjuhëve romane perëndimore. Për sa u përket më në fund huazimeve prej latinishtes kishtare, të cilat janë me rëndësi edhe nga pikëpamja e historisë së kulturës, po që gjer më sot pak kanë tërhequr vëmendjen e dijetarëve, këto kanë hyrë në gjuhë kryesisht si elemente savante me anë shkrimesh letrare ¹². Duke përmbledhur, do të thuhet se në elementin latin të shqipes do të bëhen zbritje të forta (rreth katërqind fjalë), porse ky element, edhe me ato zbritje, sidomos në pikëpamje kualitative mban vendin e parë ndër huazimet e kësaj gjuhe.

Pozita e Shqipërisë brenda në zonën e kulturës romake-greke e romane-bizantine, pati për pasojë që jo pak elemente latine depërtuan në gjuhën shqipe nëpërmjet të greqishtes dhe jo pak elemente greke hynë

11) Khs. edhe Studii si cercetări lingvistice X 4 557, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. XVI 4 f. 127v., 143v, XVII Nr. 3 f. 97v., Studia albanica I 1, 181.

12) Khs. edhe *Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes*, Revue (roumaine) de linguistique VII, 1, 178.

nëpërmjet të latinishtes. Nga grupi i parë le të përmenden ndër të tjera fjalët *flamur*, *kapistër*, *qiri*, *vistár*, *visár*, nga i dyti, *drangue drangua*, *gësh-tenjë*, *kishë*, *shpatë*. Mënyra e theksimit, e cila është një kriter i mirë dallimi në këtë fushë, tregon se p.sh. fjala *qershí* ka ardhur drejtpërdrejt prej gr. së vjetër *κεράσια* (jo prej lat. *cerasum*), porse m'anë tjetër përrallë ka dalë nga lat. *parabola*, jo drejtpërdrejt nga gr. *παραβολή*. Ndonjë term sidomos i gjuhës kishtare ka shtegtuar në gjuhën shqipe me trajtë dyfishe. Kështu, bie fjala, *parríz* vjen prej lat. *paradisus*, po trajta *parajsë* është një huazim më i vonë prej gr. *παράδεισος*; lat. *savante idolum* ka dhënë shqip *idól*, po gr. (e mesme ose e re) *εἶδωλον* dha *idhull*. Nga emrat vetjake kishtare, *Pāl* është lat. *Paulus*, *Ndue* lat. *Antonius*, po *Lezhdër*, *Qurk*, *Todër*, sipas N. Joklit, janë Ἀλέξανδρος, Κυριακός, Θεόδωρος. Greke-bizantine janë edhe *Mitër* (Δημήτριος) e *Mëhill* (Μιχαήλ), nga të cilët janë formuar dhe emrat e muajve *shëmitër* «tetor» e *shëmëhill* «nëndor». Për disa emra të tjera, puna e burimit, a latino-romane a greko-bizantine, mbetet çështje e hapët. Sikundër shihet, jo vetëm lufta e gjatë e dy kishave, po edhe lufta e dy gjuhëvet botërore të lashtësisë, ka lënë gjurmët e saj në gjuhën shqipe.

Pyetjes se a ka elemente të mocme të shqipes në latinishten provinciale, N. Jokli i ka dhënë përgjegje pozitive, duke spjeguar fjalën *grosa* «gërrësë argjendarësh» prej shq. *gërrusë krusë* «vegël me të cilën gërryejnë»¹³. Ky dijetar (në një kumtim me gojë) edhe glosën *equa bardia* «ἵππας φοράς, pelë mbarsë», që del një herë në Corpus Glossariorum Latinorum, e ka lidhur me fjalën *barsë mbarsë mbratë* të shqipes. Atëherë, ndër të tjera, edhe *baro baronis* «torollak, njeri i pagdhundur e i trashë» mund të bashkohet me *bëruo* «bariu» të shqipes së vjetër, e cila ka dalë prej një forme bazë **barōn*; gjithashtu edhe *lama* «vend i ulët, i lagshtë a moçalor», e cila, pas gjurmimeve të G. Rohlfisit¹⁴, edhe sot si emër visesh është e shpeshtë sidomos në Apuli, mund të lidhet me *lamë lëmë, një lëmë gjak* të shqipes¹⁵. Me ç'rrugë kanë shtegtuar fjalët e këtij lloji në latinishten, a prej Gadishullit ballkanik, a prej Italie jugore, kjo nuk është e mundur të ndiqet më tej.

Ndër gjuhët romane, sikundër edhe pritet nga gjithë situata gjeografike e kulturhistorike, ajo që ka ndikuar më fort në gjuhën shqipe është italishtja. Gjurmët e dalmatishtes, të cilat s'janë të shumta, do të meritonin një trajtim më vete. Prej dialektit aromun të rumanishtes shqipja ka marrë disa terme kryesisht nga të sferës baritore. Përveç këtyre, në këtë gjuhë dhe në nomenklaturën topike të saj ka gjurmë interesante të disa dialekteve rumune të tjera, mbi të cilat ka tërhequr vëmendjen N. Jokli¹⁶. Më anë tjetër, fqinjësia e gjatë edhe simbioza e aromunëve me shqiptarë ka sjellë me vete jo vetëm në veshje, në këngë e në të tjera fusha të folklorit, po edhe në gjuhën e kësaj popullsie rumune një ndikim të shënueshëm nga ana shqiptare, i cili meriton të hetohet më thellë. Në lidhje me përkimet, me konkordancat që ekzistojnë midis shqipes e rumanishtes, në interpretimin historik të së cilave dihet se mendimet shpeshherë janë

13) Studien zur alb. Etymologie und Wortbildung 23.

14) Archiv für das Studium der neueren Sprachen 184, fash. 3/4, shkurt 1944, f. 104.

15) Rendiconti Istituto Lombardo di Scienze e Lettere 99, f. 216.

16) Revista filologica II 246vv., Zeitschrift für Ortsnamenforschung X 197vv., Studia albanica I, 2 75vv.

të përkundërta, duhet të thuhet se ato nuk rrjedhin prej një periode gjuhësore të vetme, po u përkasin disa shtresave të ndryshme. Është për të vënë re, përveç kësaj, që — sikundër e ka theksuar N. Jokli disa herë — një numër bukur i mirë i këtyre barazimeve pjesore (konkordancave parciais) gjejnë spjegim me mjetet gjuhësore të shqipes. Kështu fjala *këlbazë* (rum. *câlbează* po me atë kuptim), sikurse e pa Gustav Meyeri f. 222, shkon me foljen *kalb kalbem*; gjithashtu *brisk* (rum. *brîscă* «brisk xhepi, biçak»), si «thikë me bisht prej briri» shkon me *bri*, prej nga është formuar dhe *dele briskë* «dele me brirë». Ashtu edhe fjala *shtrungë*, e cila me trajtën *strunga* del edhe në disa gjuhë ballkanike, ndër to dhe në rumanishten, në gjuhën shqipe ka edhe kuptimin «vend për të fjetur, shtrat, krevat, shtresë», dhe është formuar nga *shtroj* «bëj gati shtresë e mbulesë për të fjetur» me anë të sufiksit *-ungë*, ashtu si është formuar *shtëllungë* «lesh i larë e i shturë sa për një furkë» nga *shtjell* «shprish, shtëllis leshin» etj.

✓ Ndikimi i sllavishtes mbi shqipen përfshin kulturën materiale e mendore, veçse aty përgjithësisht mbizotëron e para ndër këto dy fusha. Huazimet me burim prej serbokroatishtes vetëm në disa rase të veçanta mund të dallohen me mjete gjuhësore prej huazimeve bullgare. Aty përgjithësisht zotëron ky kriter, që elementet që janë të përhapura në Shqipëri veriore, rrjedhin prej serbokroatishtes, ato që janë me përdorim në Shqipëri jugore e të mesme, vijnë prej bullgarishtes. Pavarësisht nga çështja e një burimi të tillë, për elementet sllave do pasur parasysht, që — në kundërshtim p.sh. me elementet latine—një pjesë e mirë e tyre ka vetëm një përhapje dialektore, gjë që sigurisht ka lidhje me mënyrën e ngulimit të sllavëve në Shqipëri. Sikundër thekson me të drejtë dhe N. Jokli, dijes i bie barra edhe në lidhje me këtë çështje të kryejë dallimet që duhen. Me anë tjetër është për të vënë re edhe ndikimi i shqipes mbi gjuhët sllave që janë fqinje me të. Për këtë ndikim, i cili është me rëndësi për ballkanistikën, nuk ka dalë ende një studim monografik, vetëm I. Popovići i ka kushtuar atij një kapitull në veprën e tij «Historia e gjuhës serbokroate» (f. 600 vv.), të botuar më 1960. Elementeve të shqipes që përmenden atje, e që për një pjesë gjinden që te Gustav Meyeri, për serbokroatishten mund t'u shtojmë edhe këto më poshtë: *brina* «breg, buzë, zgrip» prej shq. *brinjë*, bosnj. *ente* «ind (i pëlhurës)» prej një shkalle më të vjetër të foljes *end* «vej, bëj pëlhurë», *frus* «lloj puçrrize» nga *fruth*, *fuga* «Oriolus» nga *fugë* «femra e bengut, e fikësit», *landa* «rrotull, felë» nga *landë* «dru pylli, lëndë», *maz* «gjalpë» nga *mazë* «ajkë e qumështit; një farë djathi i butë e me shumë lyrë», *puljiz* «lloj rrushi» nga (rrush) *pulëz*, *turin* «turi» nga *turi turini*, duke lënë jashtë disa të tjera. Nga fusha e bullgarishtes le të përmendim p.sh. *kekav* «i dobët, shëndetlig, i pafuqi», nga *keq* «sëmurë rëndë», e cila me këtë kuptim ka hyrë dhe në greqishten e re¹⁷. Parimisht duhet shënuar se elementi shqiptar i gjuhëve sllave jugore e i dialekteve të tyre u përkët disa shtresave kronologjike të ndryshme, të cilat ndryshojnë nga njëratjetra edhe në punë të shtrirjes gjeografike të tyre. Elemente të shqipes ka edhe në gjuhët e fshehta të zejtarëve të fushës serbokroate e bullgare, ashtu si ka edhe në ato të greqishtes së re që u zunë

17) Rasa të tjera të Vl. Georgiev, Въпроси на българската етимологија, passim.

ngoje më sipër. Një bibliografi e pasur për to (Jagić, Shishmanov, Duridanov, Arnaudov, Trojanović, Barić, Filipović, Petrovici e të tjerë) gjindet te C. Tagliavini¹⁸. Ndonjë shtesë mund të bëhej nga vjetet e fundit¹⁹. Le të shtojmë më në fund që dialektet sllave që janë kufi me trevën gjuhësore të shqipes, paraqesin edhe në sistemin fonetik e morfologjik të tyre një ndikim nga ana e kësaj gjuhe, për të cilin kanë tërhequr vëmendjen sidomos O. Brochu²⁰, A. Selišcevi²¹, M. Małecki²², P. Skoku²³ dhe Tagliavini në vendin e cituar.

Kur të vështrohen marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje në tërësinë e tyre, do të pranohet që roli dhënës i kësaj gjuhe ndaj atyre gjuhëve është çmuar disi nën shkallën reale që i përket, dhe që dijen këtu e presin detyra të reja në të ardhmen. Më anë tjetër, elementet e shqipes që kanë shkuar në gjuhët fqinje, janë me rëndësi edhe për vetë historinë e kësaj gjuhe, për arsye se ato kanë ruajtur në ato idioma shpeshherë trajta më të vjetra, të cilat në gjuhën vetë që i dha, në shqipen, humbën me kohë dhe u zëvendësuan me të tjera. Për të dhënë vetëm disa shembëj, le të përmendim ndonjë rasë me metaforë ende të pazbatuar, si rum. *brad* «bredhi» përkundrazi- shq. *breth*, dhe serbokr. *škrapa* «gumë» përkundrazi *shkrep-it* të shqipes; gr. e re *γαμινάτα* «ajo që mbetet në fund të enës ku zihet djathi», me ruajtje të -n-së ndërzanore, përkundrazi tosk. *grëmëratë* «kullostër» (me rotacizëm); rum. *țarc* «vathë; rrethim, thurimë» përkundrazi shq. *thark*, e cila ka kryer ndrimin e afrikatës në spirantin interdental. Në lidhjet që kanë gjuhët në mes të tyre, të marrët e të dhënë janë me rëndësi të barabartë.

R é s u m é

L'ALBANAIS ET LES LANGUES VOISINES

Cette esquisse reproduisant une conférence tenue en janvier 1966 à l'Université de Vienne, se propose surtout de présenter dans un cadre sommaire les relations de l'albanais avec les langues voisines. Ces relations sont déterminées en première ligne par des facteurs d'ordre géographique: l'albanais occupant une position périphérique et centrale en même temps, selon qu'on considère son territoire du point de vue de l'emplacement des langues balkaniques, ou bien de celui de la péninsule des Apennins.

Le premier document écrit de l'albanais est une Formule de baptême remontant à l'année 1462, mais il y a pourtant des indices qui attestent un emploi littéraire antérieur de la langue.

L'actuelle structure dialectale, comprenant les parlers guégues dans la partie

18) Le parlato albanesi di tipo ghego orientale 73vv.

19) Khs. p.sh. U. Kънчев, Izvestie na Inst. za bulg. ezikъ IV, 1956 (Sinolso afër Pirdopskos, Bullgari).

20) Die Dialekte des südlichsten Serbiens. Schriften der Balkancommission, Linguistische Abteilung III, Vjenë 1903, shtylla 5v.

21) Makedonski Pregled VII 33vv.

22) Sprawozd. Polksk. Akad. XIV 59v.

23) Revue Int. des Et. Balk. II 290vv.

du nord, du nord-est et de l'est du pays, et le tosque dans sa partie méridionale, outre les divers îlots linguistiques de Grèce, d'Italie, de Dalmatie, etc., est le résultat d'une évolution dans l'espace et le temps. D'une analyse des traits distinctifs des deux groupes dialectaux, il résulte que ces groupes ont été jadis, en général, plus proches l'un de l'autre que dans leur état actuel. Il ressort encore que dans la période littéraire de la langue, le tosque se présente plus conservateur, le guégue plus enclin aux innovations, et que pendant la période pré littéraire, médiévale, par contre, c'est le guégue qui conserve le plus, et le tosque qui innove.

La structure phonétique, morphologique et lexicale de la langue, tout en étant assez bien étudiée pendant un siècle de travail scientifique, est susceptible de précisions ultérieures en divers sens. De l'ancien système phonétique, il existe des règles assez précises concernant la quantité des voyelles toniques. Des conclusions nouvelles s'imposent tout aussi par rapport au traitement d'un ancien *ai*, d'un *j* initial, des groupes *sk*, *ks*, *nd*, et des groupes initiaux *vr-* et *vl-*, ainsi qu'à propos de la gémination expressive d'un *r*, etc. De la structure morphologique, ce sont notamment le système de l'article et celui des cas qui nécessitent un examen nouveau. Du lexique, pas toute la partie héritée est à considérer de formation ancienne. Outre les dérivés et les composés, ce sont surtout les formations se regroupant autour de mots primaires, ensuite les onomatopées comme *fink* «pinçon», les mots dérivant des appels ou des noms de personnes (*gjon* «espèce de duc», proprement «Jean»), les lexèmes formés dans la contexture de la phrase (*kushtrim* «appel aux armes, alarme», sens propre «qui est brave»), qui doivent être considérés en général comme des créations internes et relativement tardives de la langue. Comme on le voit, la considération de la chronologie des faits de langue, du domaine phonétique et grammatical aussi bien que de celui du vocabulaire, un des premiers principes en linguistique, s'impose d'autant plus dans l'étude de l'albanais, langue à documentation littéraire assez tardive.

Tout en étant une langue indo-européenne, l'albanais est en même temps, tout aussi comme le grec, un membre de l'union des langues balkaniques. Ces langues présentent, comme on sait, des affinités remarquables entre elles, lesquelles sont le résultat de facteurs d'ordre géographique, historique et social, embrassant les divers aspects de la civilisation matérielle et morale des peuples qui les parlent. A cet égard, c'est notamment le bilinguisme, fréquent surtout dans les régions de frontière, qui a contribué d'une façon considérable à la naissance des traits qui peuvent être regardés comme typiques pour les langues de cette péninsule européenne.

L'albanais est l'unique langue balkanique où on peut constater avec certitude des emprunts provenant du grec ancien. Ces emprunts sont également d'intérêt pour le grec aussi, spécialement pour l'histoire de son système phonétique. A côté de ces emprunts, on trouve des équations partielles, telles *σιδη*:*shëgë* et *σάκος*:*thes*, qui dérivent de sources communes à ces deux langues. D'un intérêt particulier sont les éléments doriens de l'albanais, provenant des anciennes colonies doriennes du littoral albanais, et probablement aussi des parlers grecs du nord-ouest. Pour une période postérieure, l'époque byzantine sont à relever notamment les emprunts dûs à la sphère ecclésiastique. A regrouper ici tout aussi l'inscription ANA OHOH ICER, trouvée en Albanie du Nord, considérée longtemps à tort d'origine illyrienne, contenant dans les deux premières pièces l'impératif grec médiéval *ἀναβοήθει* «aide». Sans aborder la question, si débattue, si c'est à l'action du grec qu'il faut ramener la perte de l'infinitif et la formation du futur dit volontatif dans les langues balkaniques, y compris l'albanais, on doit retenir que l'infinitif de cette langue n'est dans l'origine qu'un participe, employé dans des phrases d'un type particulier. Dans le champ des relations d'interférence entre le grec et l'albanais est à signaler également

une influence albanaise dans le grec. A côté de la présence d'un bon nombre d'emprunts albanais dans le vocabulaire du grec moderne et de ses dialectes, où il y a lieu d'ajouter des éléments restés inaperçus jusque-là, on doit envisager le problème de l'existence d'anciens éléments albanais ou préalbanais en grec ancien, problème digne de considération, et déjà résolu, en partie, dans un sens positif.

Par la manière du traitement des emprunts faits au latin, l'albanais occupe une place à part, s'approchant d'un côté du roumain et du dalmate, de l'autre côté des langues romanes occidentales. Tout en étant susceptible d'une forte restriction, du point de vue qualitatif l'élément latin tient la première place parmi les emprunts de l'albanais. Présentant notamment — contrairement au roumain — un caractère urbain, cet élément prédomine également dans le langage ecclésiastique, où l'élément grec, bien que dans une moindre mesure, est de même représenté, tandis que une influence slave manque complètement. Tout comme dans le domaine des emprunts grecs, dans celui des emprunts latins il convient également d'appliquer une certaine périodisation, des regroupements d'ordre chronologique. A relever ici particulièrement la présence de mots remontant au latin tardif et au médiéval. Une tâche à soi consiste à discerner les emprunts latins de l'albanais de ceux provenant du grec ancien, notamment les éléments grecs pénétrés à travers le latin, et les éléments latins transmis par voie du grec. Par rapport aux relations de l'albanais avec le latin, on ne devrait, enfin, perdre de vue certains éléments lexicaux du latin (provincial) de probable origine balkanique, et précisément albanaise ancienne ou préalbanaise.

En ce qui concerne les rapports de l'albanais avec les langues romanes, il va sans dire que l'action de l'italien, continuateur en cela du latin, a été de tout temps prépondérante. A propos des relations avec le roumain et ses dialectes, on doit faire remarquer la présence en albanais de certains termes d'origine aroumaine relatifs à la sphère pastorale, et, d'autre part, une influence albanaise dans les costumes, les chants et le langage de cet embranchement de la nation roumaine. Quant aux concordances lexicales albano-roumaines, il convient de tenir présent qu'un bon nombre de ces éléments communs aux deux langues, trouvent leur place dans le vocabulaire et le système morphologique de l'albanais, ils sont donc à considérer d'une manière objective des formations de source albanaise.

L'action exercée par le slave sur l'albanais embrasse en grande partie le domaine de la culture matérielle plutôt que celui de la culture spirituelle. Dans ce champ, les critères dont on dispose pour discerner les emprunts dûs au serbo-croate des emprunts bulgares, sont souvent d'ordre géographique plutôt que purement linguistique, l'identité des formes de mots dans ces deux langues slaves étant assez fréquente. Un autre fait relevant pour juger du caractère de cette influence, linguistique et sociale, consiste dans l'extension en grande partie régionale des emprunts slaves. A remarquer, en outre, que, comme, du reste, dans les relations de l'albanais avec les autres langues voisines, ici encore il faut considérer l'action de l'albanais sur les langues slaves limitrophes et leurs dialectes, tant en matière de lexique que de phonèmes et de formes grammaticales. Un chapitre à soi forment les éléments albanais dans les argots de métier d'usage dans ces langues.

En résumant, on peut dire que le rôle actif de l'albanais envers les langues voisines étant, jusqu'à présent, quelque peu sous-estimé, la recherche scientifique se trouve devant des tâches nouvelles. Ces relations d'emprunt ont, outre cela, de l'importance pour la reconstruction interne de l'albanais. C'est que les éléments de cette langue pénétrés dans les idiomes des peuples voisins, ont conservé souvent chez eux des formes que l'albanais a remplacé entre-temps par des innovations.